



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR
KRYETARI

Nr. 720 Prot.

Shkodër, më 23 12 2024

Vendim


Nr. 29, Datë 20 / 12 / 2024

“PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES DHE SHPËRBLIMIT TË SPECIALISTËVE TË JASHTËM QË DO TË CAKTOHEN NË KOMISIONE TË NDRYSHME PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2025”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Zhvillimit e Bashkëpunimit me Jashtë “Për miratimin e pjesëmarrjes dhe shpërblimit të specialistëve të jashtëm që do të caktohen në komisione të ndryshme, për Këshillin e Qarkut Shkodër për vitin 2025”, bazuar në nenin 77/ç të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. ____/2024, “Për Buxhetin e Vitit 2025”, nenin 6/c dhe 9 të Ligjit nr. 35/2023 “Per kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës minimale në shkallë vendi”, Ligjit Nr.94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, ligjit Nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 8, Dokumentet për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”, Udhëzimit nr.143, datë 19.07.2024”, Buxhetin e vitit 2025, në funksion të realizimit të përgjegjësisë ligjore të administratës të KQSH-së, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u miratua me 17 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim;

VENDOSI:

1. Miratimin e pjesëmarrjes dhe shpërblimit të specialistëve të jashtëm që do të angazhohen sipas nevojave në komisione vlerësimi apo në komisione të ndryshme sipas përkatësisë dhe nevojës për pjesëmarrje.
2. Miratimin e shpërblimit të specialistëve të jashtëm, të angazhuar në Komisione për Këshillin e Qarkut Shkodër për vitin 2025, në masën 10,000 (dhjetëmijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në procedurë apo për shërbim të kryer, sipas kontratës së angazhimit.

- 
3. Miratimin e pjesëmarrjes dhe shpërblimit të specialistëve të jashtëm, shtesë në komisionin e vlerësimit të figurave, si më poshtë;
- 2(dy) specialistë për dhënien e titujve vendore të nderit,
 - 2(dy) specialistë për shtesa për pension të veçantë
 - 2(dy) specialistë për njohjen e statusit për dëshmorin e atdheut,
4. Miratimin e shpërblimit të specialistëve të jashtëm, shtesë në komisionin e vlerësimit të figurave në masën 10,000 (dhjetëmijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në vlerësim.
5. Burimi i Financimit do të jetë Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2025 e planifikuar në Art. 602 .
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

